

VENDIM
Nr.511, datë 13.5.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshillit i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 5.4 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Disbalancat (devijimet), nga programi javor, deri në maspn +/-5%, do të vlerësohen disbalanca (devijime), për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk do të paguajnë sanksione, por kanë detyrimin që, për javën/javët pasardhëse, të planifikojnë rregullimin e këtyre disbalancave (devijimeve).”.
2. Në fund të nënndarjes “Të arkëtueshme/të pagueshme” të pikës 6.1 vendoset shifra “+/-5%”.
3. Në fund të nënndarjes “Të arkëtueshme/të pagueshme” të pikës 6.2, vendoset shifra “+/-5%”.
4. Në fund të nëndarjes “Të arkëtueshme/të pagueshme” të pikës 6.4, vendoset “shifra+/-5%”.
5. Në fund të paragrafit të parë të nënndarjes “Të arkëtueshme/të pagueshme”, të pikës 6.5 vendoset shifra “+/-5%”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha